

NACIONAL

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Vepra e Blloshmit dhe Lekës i bashkohet humanizmit europian

Disidenca letrare e Vilson Blloshmit

Nga Bujar Leskaj

faqe 10



Muharrem Xhediku, kompozitori që u bë prift me dokumenta të rreme

Dashuria me vajzën e drejtorit të kampit nazist

Dossier nga Sakip Cami

faqe 18



EDITORIAL

Idhullomania

Nga Nazmi Lukaj

Edhe në politikë, edhe në kulturë, edhe në arsim, edhe në publicistikë e në të gjitha sferat e tjera, pak intelektualë janë të veçantë. Të tjerët janë imitatorë të të tjerëve. Edhe në jetë sillen si ata. Edhe stilin e kanë, po të njëtin, me idhujt e tyre. Sado që disa sish janë intelektualë të zotët, për shkak të imitimit të të tjerëve, reflektojnë artificializëm. P.sh., shumë studentë të Universitetit të Prishtinës, pasi i kanë kryer studimet, e kanë imituar ndonjërin nga mësimdhënësit e vet, që e kanë pasur idol. Disa sish janë edhe doktorë shkencash. Madje, edhe shumë të shquar, por nuk janë liruar as sot nga sjelljet në jetë si të mësimdhënësve të vet. Edhe kur shkruajnë, kanë stil identik me idolët e tyre. Madje, edhe kur flasin, i imitojnë ata!!! Edhe lëvizjen e duarve dhe mimikën e fytyrës ua imitojnë plotësisht!!! Andaj, shumë libra me kritikë letrare thua se i ka shkruar po e njëjta dorë... Kjo ngjet edhe në publicistikë. Shumë publicistë i imitojnë stilet e të shkruarit të autorëve të mëhershëm. Lehtë mund të vërehet kjo gjë, madje edhe nga lexuesit e thjeshtë. Të krijohet përshtypja sikur jemi 20 vjet pas në publicistikë. Kjo ndjehet edhe në politikë. Për shembull në Tiranë shumë politikanë imitojnë lidërit e partive të tyre, jo vetëm në stilin e të folurit, por deri edhe në veshje, në krehje të folokëve, në mimikë dhe fjalor. Kjo i bën ata shpesh qesharakë dhe të pabesueshëm në opinion, sedomos kur gratë përshtasin stilin e komunikimit të lidërve burra, stilin e replikave, polemikave, biles edhe të shakave dhe humorit të tyre. Ky epigonizëm ka edhe pasojat e veta. Shikoni se sa pak stile të veçanta kemi në publicistikë, në kritikën letrare, në letërsi. Kjo vjen si rrjedhojë e respektit për idhujt. Respekti për ta e ka kufizuar stilin e tyre. Ose, thënë më sakt, e ka njëjtësuar me atë të idolëve. Sa më shumë që imitohen idhujt, aq më shumë dëmtohen edhe publicistika, edhe kritika letrare, edhe letëria, edhe...P.sh., në arsim, metodat e reja shumë pak mësimdhënës mund t'i përvetësojnë, pikërisht për shkak se kanë mbetur

Vijon në faqen 2

Artistja e mirënjohur e Operas, Shpresa Spaho rrefen për "Nacional"

Si këndova përkrah Plaçido Domingos...

faqe 3

Fëmijëria...

Poezi nga Mimoza Sali



Pezi nga: Samuel Becket, Geoffrey Squires, Cathal Searcaigh, Dermot Healy, Paul Durcan, Patrick Kavanagh, Tony Curtis, Michael Foley, Richard Murphy, Seamus Heaney, Andrew Elliot, Sean Dunne, Geoffrey Squires, Medbh McGuckian, Padraig Daly, W.B. Yeats, James Simmons. Esse nga: Arjana Lukaj, Dinis Celcima, Xhahid Bushati

Në BRENDËSI

Nobelisti Oktovio Paz

Studim nga Endrit Shtylla

faqe 5

Murgjit alfabetikë

Tregim nga Moikom Zeqo

faqe 6

Takimi Tito-Balluku

Dossier nga Dr. Ilir Kelmendi

faqe 16

Një dallgë nga oqeani

Poezi nga Rainer Schulte

faqe 12

Tirkani

Tregim nga Izet Shehu

faqe 8

Kush e vrau Jusuf Gërvallën?

Reportazh nga Asllan Dibrani, Gjermani

faqe 4

Balada e vendlindjes

Poemë nga Jak Përpali

faqe 15

Poezia e Bajazit Cahanit

Esse nga Besim R. Cengu

faqe 22-23

Si po boshatiset Manastiri nga Shqiptarët

Koment nga Fergim Demiri

faqe 19




Albanian Refining & Marketing of Oil

PËR HERË TË PARË
EURODIESEL
I STANDARTEVE EUROPIANE

PCALBANIA
Broker Sigurimesh

Aty ku siguria është Art

NJË DALLGË NGA OQEAN



Nga Rainer Schulte

Delikatë në shpresat tona
zbuluam vazhdimësi në
lumin e trupave tanë.

Dhe tani
unë kërkoj gjithkund
pika presioni pa ty.

JETË NATE

Telefonat
nervozizmi i tyre
ndërpritet në veshë.

Nata pret koka
vikatje zërash
të futura nga dreka
për tek pasditja.

Rainer Schulte është i njohur në letërsinë e sotme Amerikane si poet, përkthyes, dramaturg, eseist e kritik letrar. Pas mbarimit të studimeve në filozofi në universitetin e Gutenberg-ut në Mainz, ai studioi edhe për piano në akademinë e famshme të muzikës të Darmstadt-ut. Doktoraturën (Ph.D.) në Letërsinë Krahasuese e fitoi në Universitetin e Michigan-it. Schulte është drejtori i Qendrës së Përkthimeve Letrare të Amerikës dhe redaktor i revistës së njohur "Translation Review". Krahas punës si profesor i Arteve dhe Humanizmit ia ka arritur t'i japin letërsisë botërore disa vepra letrare shumë të rëndësishme të krijimtarisë së tij.

Askush nuk flet
përveçse kimia
e gjakut tonë
ndërkohë që hëna dhunon
trupat tanë.

Meshtarët
tepër të dobët të lakuriqësohen
fshihen mbas mëkateve
të fetarëve.
Ata nuk kanë njohur kurrë
uri
në gjakun e tyre
dhe nuk kanë dëshirë
ta kthejnë ujin
në verë.

POEZIA LAKURIQE

Sytë e mi
të kanë zhveshur ty
gjatë gjithë ditës.

Trupi yt
një gjeografi
që gjuha ime
akoma s' e ka eksploruar.

Netët
e trupave tanë
janë pa kufi.

Asnjë barrierë
s' na e përmban dot
rrjedhën e lëngjeve të gojës.

Unë të prek thonjtë e këmbëve
një tërmet
vërshon nëpërmes shalëve tuaja
tek trupi yt.

Më thatë:
e dua trupin tënd.
Skuqja ime
bëhet me e kuqe
se gjaku ynë.

Gjuha jote
shpon qiellin brenda meje
unë ngre
dallgët e oqeanit.

Trupi yt

vibron
madje dhe pas largimit tim.

Në tavolinë
brenda teje
unë vendos
të jetoj.

Të gjitha ëndrrat e mia
janë mbushur me ritmet e tua.
Gishtërinjtë e mi
të krehin ty
nga brenda.

Trupi yt është i pashtershëm.
Frymëmarrja jote mbush
hapësirën e natës.

Duart e mia mbajnë mend
lëkurën tënde
më fort se poezinë.

Hëna e plotë
mbolli pangopësinë
në thithat e tua.

Shija e tyre
ushqen gjuhën time
më gjatë se kujtimi
i verës.

Gjuha ime
një pendulum
mes thithave.
Trupat tanë takohen—
ata i japin natës frymën
e pafundësisë.

Pastaj dielli
hezion
para se të ngjitet
mbi horizont.

Kur të tjerët përdorin
parfumin tuaj
unë të zhvesh ty.

Historia e prekjes sate
mund të shkruhet vetëm në lëkurë.
Netët zgjerojnë
dëshirat tona.

Unë u zgjova
vetëm në shtratin tim
me sisët e tua në duar.

Harqet e trupit tënd
janë më jetëgjatë
se katedralet.

Trupat tanë flasin
sapo buzët tona
u mbyllin gojën fjalëve.

Midis meje e teje
ka vetëm një ritëm.

Kur ti hap veten
diga fillon të thyhet
dhe furia e ujit
ushqen flakët e mia.

Brenda trupit tënd
nevoja për të shkruar poezi
venitet.

Trupi yt
është oqean.

Asnjë anije
s' ka për të arritur kurrë
bregun tënd.

Vendet
ku dita dhe nata
u shndërruan në zjarr
na ndjekin pas.

Kur ti vure
duart në trupin tim
bota krijoi një gjeografi të re.

MARTESA

Fjalët
e kanë humbur sipërfaqen sensuale
në lëkurën e tyre.
Me fjalorin e domethënies
ecin me paterica
nëpërmes ditëve të gjata
tepër të dobëta të hapin
derën
tek të gjitha përqaftimet
që kurrë nuk realizuan.


Ëndrrat
shkrijnë akullin e ditës
ndërsa gjaku ngurtësohet
drejt ritmeve të
dëshirave

para se drita në
fund të tunelit
i fut frikën
pëmës në rrëzim.

Unë rrëgjohem
tek vetja
një kafaz i farkuar
rreth botëve të mia
sytë e së cilave janë tepër të mekur
t'ia thyjnë hekurat.

Ka ardhur koha
të kërkoj fluturime aeroportesh
ku mund të marr
leksione në lamtumirë.

Përktheu nga anglishtja: Gjekë Marinaj



NJË DALLGË NGA OQEAN

Dallgët e oqeanit
qenë më të qeta se
ritmi i trupave tanë.
Asgjë nuk pat humbur
për njëzet vjet.
Ne vibruam tek nata
të pavëmendshëm ndaj britmave të oqeanit.
U ngritëm nga e kaluara
për te kjo natë
e cila u bë nata e të gjitha
netëve të kaluara.
Trupat tanë i shtynë dallgët
si era
mbi lëndinat e gjelbëruara.

Nuk bëme asnjë pyetje.

E kaluara përsëriti veten
në qarkullimin e gjakut tonë:
natyrale dhe e fortë.

Ju ngjallët fortësi tek unë
duke shtrirë trupin tuaj
për te mëngjesi.